

PROCESVERBAL 25/2022

I mbajtur me rastin e takimit të 11 (njëmbëdhjetë) të rregullt për vitin 2022 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 25.11.2022 duke filluar nga ora 09:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;

3.Të ndryshme;

Takimin e hapi Kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Aprovohet pika e 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2023-2027;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe fjalën ia jep zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - në KPF ky plan është miratu për Asamble.Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe strategjinë shtetërore kundër korrupsionit si dhe planin e veprimit kundër korrupsionit,i hartuar dhe miratuar nga qeveria e Kosovës e cila i obligon të gjitha institucionet shtetërore që të zhvillojnë dhe të miratojnë planet e integritetit,me vendim të Kryetarit është formuar grupi punues për hartimin e këtij plani të integritetit.Ky plan synon të kontribuoj në ndërtimin e një administrate komunale profesionale dhe të modernizuar me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve përmes ofrimeve të shërbimeve sa ma efikase dhe cilësore.Zyrtari ligjor tutje flet rreth hartimit të këtij plani.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Të ndryshme;

Kryesuesi - hap debatin për këtë pikë.

Nazim Shabanaj - kam një shqetësim të cilin e kam paraqit edhe më herët.Lodrat e fëmijëve që janë rregullu më herët janë demolu.Kërkoj që të rregullohen.Gjithëashtu shqetësimi tjetër është edhe te ura.

Kryesuesi - nuk e di a e ka me patjetër zyrtari për Komunitete dhe Kthim me qenë pjesë në takime,apo e ka vetëm kur don me ardhë?

Avni Bytyqi - duhet të vijë por është fundi i vitit dhe mundet me qenë nëpër trajnime.

Kryesuesi - janë 4-5 takime që ai nuk merr pjesë.Unë dua ta di gjendjen sa i përket komuniteteve në Suharekë.Unë si kryesues kërkoj që atij ti bëhet një vërejtje me shkrim.

Avni Bytyqi - nuk ke të drejtë. Ai nuk i raporton as Komunitetit për Komunitete, as KPF-së dhe as Kuvendit. Ai e ka një epror që merret me të.

Kryesuesi - unë nuk thashë me raportu, por thashë pse nuk merr pjesë në takime.

Avni Bytyqi - ju mundeni me ngrit si shqetësim dhe ne me adresu te ai që me marrë pjesë në takim.

Nazim Shabanaj - për problemet për komunitete, ku duhet me shku mu anku?

Avni Bytyqi - në zyrën për Komunitete dhe kthim.

Takimi përfundoi: 09:15